

KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletëpërgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka nga një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë A B C D E

Gabim A B C D E

- Bëni kujdes për të mos dalë jashtë rrethit kur të kodoni përgjigjen në fletë-përgjigjen e provimit.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si zhgarravitje, rrudhosje etj.
- Mos ju përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 4 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e Testit 1 që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan "TEST - 1", përgjigjet e Testit 2 do të kodohen në fletë përgjigje në pjesën ku shkruan "TEST - 2".
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Kodoni me kujdes preferencat tuaja për shkollat në të cilat dëshironi të studioni. Rezultatet dhe bursat do të shpallen sipas preferencave të bëra.

Shkolla	Kodi
"Mehmet Akif" e Mesme - Vajza në Tiranë (me konvikt)	01
"Mehmet Akif" e Mesme - Djem në Tiranë (me konvikt)	02
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Tiranë (me konvikt)	03
"Hasan Riza Pasha" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Shkodër (e mesme me konvikt)	04
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Durrës (klasat 9-12 me konvikt)	05

Suksese!

TEST-1

Pyetje: 40 Koha e parashikuar: 70 minuta

1.

Për cilën vlerë të k , $2x^2 + 2x + k = 0$ ka vetëm një rrënjë ?

- A) $-\frac{1}{2}$ B) $-\frac{1}{3}$
 C) $\frac{1}{2}$ D) $\frac{1}{4}$

2.

Në një depozitë ndodhet një sasi uji. Nëse kësaj depozite i shtohet 110 litra ujë sasia bëhet a litra, nëse i hiqet 70 litra ngelet $\frac{a}{3}$ litra ujë. Sipas kësaj sa litra ujë kishte në fillim në këtë depozitë ?

- A) 135 B) 145 C) 150 D) 160

3.

Nëse $x + 2 + \frac{m-1}{x-2} = 1$ dhe $x_1 \cdot x_2 = 2$ atëherë sa është m ?

- A) 2 B) 3 C) 4 D) 5

4.

$$\frac{2.7}{0.09} + \frac{0.35}{0.07} - \frac{4}{0.4} = ?$$

- A) -2 B) 25 C) 35 D) 70

5.

Thjeshto $\left[\frac{a}{b} - \left(2 - \frac{b}{a} \right) \right] : \frac{a-b}{a \cdot b} = ?$

- A) $-2ab$ B) $2ab$
 C) $a + b$ D) $a - b$

6.

ABC

Nëse $\frac{-BAC}{540}$ atëherë sa është vlera e $A - B$?

- A) 3 B) 4 C) 5 D) 6

7.

Sa është përfundimi i

$$(3-1) + (6-4) + (9-7) + \dots + (33-31).$$

- A) 20 B) 22 C) 24 D) 26

8.

Sa është vlera e a -së në ekuacionin

$$2^{a-b+2} = \frac{1}{2^{2a+b+1}}$$

- A) 0 B) -1 C) -3 D) 3

9.

Nëse $A = [-3; 2[$, $B =]-2; 3[$, cila nga të mëposhtmet është $A \cap B$?

- A) $[-2; 2[$ B) $] -2; 2[$
 C) $[-3; 3[$ D) $] -2; 2[$

10.

Në një grup njerëzish mosha mesatare e tyre është 40. Mbasi largohet një 30 vjeçar prej grupit mosha mesatare tyre bëhet 42. Sipas kësaj, sa persona kishte në fillim grupi ?

- A) 4 B) 5 C) 6 D) 7

11.

Cila nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë?

- A) $\sqrt{(-6)^2} = -6$ B) $\sqrt{-1} \cdot \sqrt{-1} = 1$
 C) $\sqrt[8]{(-3)^6} = \sqrt[4]{(-3)^3}$ D) $\sqrt[3]{-2} \cdot \sqrt[3]{-4} = 2$

12.

Sa është përfundimi i $\left(\sqrt{\frac{7}{3}} - \sqrt{\frac{3}{7}}\right) \cdot \sqrt{21}$?

- A) 1 B) 2 C) 3 D) 4

13.

Një nxënës fillimisht i përgjigjet $\frac{1}{4}$ -ën e pyetjeve të një testi pastaj $\frac{1}{5}$ -ën e pyetjeve të

mbetura. Ky nxënës pot'i ishte përgjigjur edhe 16 pyetjeve do të kishte përfunduar gjysmën e tyre. Sipas kësaj sa pyetje kishte gjithsej testi?

- A) 120 B) 160 C) 200 D) 240


14.

Cili është numri më i vogël i plotë që plotëson mosbarazimin $5x - 4(6 - 2x) \geq 6x - 3$?

- A) 3 B) 4 C) 5 D) 6

15.

Në figurë ABCD është drejtkëndësh me $|DE| = |EF| = |FA|$, $|BE| = 8\text{ cm}$ dhe $|EC| = 3\text{ cm}$. Sa cm është $|AB|$?



- A) 3
B) 4
C) 5
D) 6


16.

Nëse $x = 2014$ dhe $y = 2012$, atëherë sa është vlera e $(x + y)^2 - 4xy$?

- A) 2 B) 4 C) 2020 D) 4026

17.


Në figurë bazat e prizmit të drejtë janë trekëndëshat me brinjët 5, 12 dhe 13. Nëse sipërfaqja e përgjithshme e trupit është 360 cm^2 , sa është lartësia e prizmit?



- A) 8 B) 10 C) 12 D) 15

18.


Në figurë $[AB] \perp [BC], [AC] \perp [BD]$, $|AD| = 3 \text{ cm}$, $|BD| = 6 \text{ cm}$, gjej $|BC|$



- A) 9 B) 12 C) $6\sqrt{3}$ D) $6\sqrt{5}$

19.


Në figurë ABCD është paralelogram. $|AD| = |DF|$, $|AB| = 10 \text{ cm}$ dhe $|BC| = 7 \text{ cm}$. Sa cm është $|EC|$?



- A) 3 B) $\frac{7}{2}$ C) 4 D) $\frac{9}{2}$

20.

Nëse $|AD| = |DC|$ dhe $|BE| = |EF| = |FC|$, atëherë sa është vlera e raportit $\frac{A(DEF)}{A(ABC)}$?





- A) $\frac{1}{4}$ B) $\frac{1}{5}$ C) $\frac{1}{6}$ D) $\frac{2}{9}$

UDHEZIM

PER MENYREN E ZGJIDHJES SE PYETJEVE LOGJIKE

Shembull 1

Cila është pllaka që mungon?



A B C D

Udhëzim: Duke u bazuar në dy rreshtat e pare vërejmë se shigjetat tregojnë vetëm 3 drejtime (djathtas, majtas dhe poshtë). Nga lartë poshtë numri i pllakave rritet me nga një shigjetë. Pra pllaka që mungon duhet të ketë 3 shigjeta me drejtim poshtë, ndryshe nga dy pllakat e tjera. Prandaj e vetmja përgjigje e saktë është D.

Shembull 2

Cila fjalë korrespondon me 3020?

- 2131
- 6050
- 3020
- 4131
- 5131


3020 ⇒ ?

- A) YAKA
- B) SIVI
- C) TAKA
- D) VAKA
- E) KIYI

Udhëzim: Secila shkronjë korrespondon me një shifër. 3-shi gjendet në numrin e parë, të katërt dhe të pestë në shifërën e parafundit që korrespondon me gërmën K. Pra fjala që i korrespondon numrit 3020 fillon me K. E vetmja alternative që fillon me gërmën K është KIYI.

21.


Cila nga alternativat duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes?



- A) 73
- B) 88
- C) 89
- D) 92

22.



Në figurën e mëposhtme jepet një kub i hapur. Nëqoftëse faqja me ngjyrë të zezë është faqja e sipërme e kubit, cila nga shkronjat ndodhet ne faqen e poshtme?



- A) a
- B) b
- C) c
- D) d

23.

Cila nga alternativat duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes?



A) B) C) D)

24.



Cili është numri që duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes në vargun e mëposhtëm?

7 17 26 ? 41 47 52

- A) 34 B) 29 C) 30 D) 35

25.


Sipas rregullit të ndjekur në figurë, çfarë duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?



- A) B) C) D)

26.


Cila nga alternativat duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes?



- A) B) C) D)

27.

Cila nga alternativat duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes?



- A) 24 B) 26 C) 28 D) 30

28.





Cili është numri i radhës në varg?

21 20 18 15 11 ?

- A) 6 B) 7 C) 8 D) 9

29.


Sipas lidhjes së dhënë në rreshtat I dhe II, cila nga alternativat duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes?




- A) B) C) D)

30.

Në figurën e dhënë ka 6 kube.




Sa kube ka në figurën e mëposhtme?



- A) 48 B) 50 C) 52 D) 54

31.


Cila nga alternativat duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes?



- A) B) C) D)

32.

Nëqoftëse 3 peshoret e dhëna janë të balancuara, cila nga alternativat mund të vihet në vend të pikëpyetjes, pa prishur balancën?



33.


a, b, dhe c janë shifra të ndryshme.

$$\begin{array}{r} abb \\ + abb \\ \hline bc2 \end{array} \rightarrow a + b + c = ?$$

- A) 6 B) 7 C) 8 D) 9

34.

Çfarë forme ndërtohet duke përdorur pjesët e mëposhtme?



- A) B) C) D)

31.

Mbahet si një nga poemat më të ndjera të poezisë shqipe, ku poeti i thur himn natyrës, dashurisë dhe krenarisë për vendlindjen:

- A) “Këngët e Milosaos”
- B) “Bagëti e bujqësi”
- C) “Bukolikati”
- D) “Himni i flamurit”

32.

Në romanin “*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*”, figura letrare, e cila përdoret në veprat satirike, është:

- A) Ironia
- B) Metafora
- C) Epiteti
- D) Sarkazma

33.

Pjesa “*M’at anë gardhit asgja të re*”, është shkruar nga:

- A) Ismail Kadare
- B) Migjeni
- C) Martin Camaj
- D) Mitrush Kuteli

34.

Është veçori e tekstit rrëfimtari joletrar:

- A) Të vendosësh cili do të jetë rrëfyesi.
- B) Të vendosësh shkallën e objektivitetit e subjektivitetit të rrëfimit.
- C) Të vendosësh rendin e ngjarjeve.
- D) Të shkruash në bazë të të dhënave e dokumenteve.

35.

Nuk është veçori e tekstit poetik:

- A) Të komunikojë gjendje shpirtërore.
- B) Vargu.
- C) Të komunikojë ngjarje.
- D) Zgjidhen fjalët për të arritur efekte të veçanta zanore.

36.

Ka temë historike, të ngjashme me poemën “*Kënga e sprasme e Balës*”, pjesa:

- A) “Pas betejës”
- B) “Prilli i thyer”
- C) “Jesminë”
- D) “Ai...”

37.

E përbashkëta midis miteve, përrallave, legjendave, fabulave, është:

- A) Elementi real i pasuruar me elementin fantastik.
- B) Prania e hyjnive jetën njerëzore.
- C) Shpjegimi popullor mbi origjinën e botës dhe të popujve.
- D) Janë forma elementare të rrëfimit.

38.

Veçoritë e përbashkëta të tregimit me përrallën i gjejmë në pjesën:

- A) “ Djali, shkabonja dhe e Bukura e Dheut”
- B) “ Narcizi”
- C) “ Rinë Katerinëza”
- D) “ Muji dhe Halili”

39.

“Kumbulla përtej murit” është shkruar nga:

- A) Fatos Kongoli
- B) Dritëro Agolli
- C) Ernest Koliqi
- D) Zija Çela

40.

Është një nga mbrojtëset më të shquara të çështjes shqiptare në fillim të shekullit XX, e cila ka pohuar prejardhjen ilire:

- A) Xh. G. Bajroni
- B) Edit Durham
- C) Mari Kyri
- D) Sevasti Qiriaz

41.

Nisin me një hyrje karakteristike, ku thërritet për frymëzim një hyjni e caktuar:

- A) Veprat epike
- B) Veprat didaktike
- C) Veprat lirike
- D) Baladat legjendare

42.

Në romanin “Prilli i thyer”, Besiani bën një paralelizëm të Gjorgut me:

- A) Hamletin
- B) Makbethin
- C) Don Kishotin
- D) Stresin

43.

“Apologjia e Skënderbeut” është shkruar nga:

- A) Pjetër Budi
- B) Pjetër Bogdani
- C) Frang Bardhi
- D) Marin Barleti

44.

Në një tekst argumentues (ese dhe ligjëratë), hartuesi i një teksti të tillë:

- A) Thjesht paraqet të dhëna të qarta e të sakta.
- B) Këmbëngul për të dëshmuar të vërtetën e asaj që thotë.
- C) Mbron antitezat e ndryshme.
- D) Nuk ka nevojë për një tezë të dhënë, vetëm për argumente.

45.

Shprehja “*Të rrosh a të mos rrosh - kjo është çështja.*” Nga cili është thënë:

- A) Shekspiri
- B) Makbethi
- C) Hamleti
- D) Ofelia

46.

Dinakëria dhe ironia e cilit personazh, lëviz gjithë veprimin në komedinë “*Pas vdekjes*”:

- A) Zenelit
- B) Zotit Vurko
- C) Zonjës Lulushe
- D) Doktor Adham - Utit

47.

Nëse ndalemi te forma metrike e poezisë “*Liria*” e Ndre Mjedës, ajo i përket llojit lirik të:

- A) Idilit
- B) Himnit
- C) Elegjisë
- D) Sonetit

48.

Në poezinë “*Pa ty*”, Ismail Kadare, iu rikthehet dy figurave të njohura nëpërmjet figurës letrare të:

- A) Metaforës
- B) Krahasimit
- C) Epitetit
- D) Apostrofit

49.

Aristoteli mendonte se “*pikërisht ndjenja e frikës dhe e dhembshurisë, për heroin, në një tragjedi, ndihmojnë në pastrimin shpirtëror të shikuesit*”. Këtë proces ai e quante:

- A) Katarzë
- B) Fatalitet tragjik
- C) Mëshirë
- D) Tragjizëm

50.

Poezia “*Gjeniu i anijes*” e Lasgush Poradecit, është lirikë:

- A) Meditative - filozofike
- B) Atdhetare
- C) E natyrës
- D) Personale

